Numër: 01/37
Datë: 22.02.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 22.02.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni "Kolegji Europian i Kosovës", me adresë: Rr. Gustav Mayer, Nr. 19 – 10000 Prishtinë, si dhe **dega e institucionit** "Kolegji Europian i Kosovës", me adresë: Rr. Edmond Hoxha, Nr. 65 – 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 22.02.2022 deri më 21.02.2025, me kualifikimet e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1. Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë, Niveli V sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 9 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga dymbëdhjetë (12) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në gjashtë (6) grupe.

   1.2. Shitja dhe Shërbimi i Klientit, Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 30 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga njëzet (20) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahen deri në tre (3) grupe.

   1.3. Teknik i Zhvillimit te Softuerit, Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim i Bazuar në Standarde Ndërkombëtare (E) me 60 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me nga tridhjetë (30) kandidat në një grup, dhe gjatë një viti mund të mbahet një (1) grup.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit "Kolegji Europian i Kosovës", për validim, akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Kolegji Europian i Kosovës", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK